



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivered	10.05.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	4167/2023		113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.583/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë, më Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.583/2023 të datës 29.03.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] të cilin me autorizim e përfaqëson [redacted] nga Prishtina, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 10.05.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.583/2023 e datës 29.03.2023, e parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] (me tej vetëm ankuesi) i punësuar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, më datë 29.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të heshtjes administrative të organit të punësimit lidhur me kërkesën e datës 06.01.2022 dhe 22.03.2023 për kompensimin e 1000 orëve të punës jashtë orarit të punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referua Këshilli) bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.04.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit të Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, ndërsa kjo e fundit më datë 14.04.2025 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në vendosje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 3091/2023 të datës 29.03.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit me numër protokolli 3742 i datës 21.08.2012; Shkresën e datës 06.01.2022 nga ankuesi për Shefin e Sektorit Sanitar; Kërkesën për angazhim maksimal lidhur me situatën e krijuar nga ankuesit me datë 31.08.2021 për Q.A, F.K dhe I.T; Rikërkesën për kompensim e datës 22.03.2023 e parashtruar nga ankuesi për F.K, Q.A, Sh.M, A.A dhe I.T; Kërkesë për punë jashtë orarit për ankuesin e datës 12.04.2020, 18.04.2020, 19.04.2020, 25.04.2020, 26.04.2020, 16.05.2020, 15.06.2020, 19.06.2020, 20.06.2020, 22.06.2020, 28.06.2020, 01.07.2020, 05.07.2020, 07.07.2020, 10.07.2020, 11.07.2020, 12.07.2020, 13.07.2020, 14.07.2020, 15.07.2020, 16.07.2020, 17.07.2020, 25.07.2020, 28.07.2020, 27.07.2020, 29.07.2020, 30.07.2020, 31.07.2020, 01.08.2020, 03.08.2020, 04.08.2020, 05.08.2020, 06.08.2020, 07.08.2020, 08.08.2020, 09.08.2020, 10.08.2020, 11.08.2020, 12.08.2020, 13.08.2020, 14.08.2020, 15.08.2020, 16.08.2020, 17.08.2020, 18.08.2020, 19.08.2020, 20.08.2020, 21.08.2020, 24.08.2020, 25.08.2020, 26.08.2020, 27.08.2020, 28.08.2020, 29.08.2020, 30.08.2020, 31.08.2020, 01.09.2020, 02.09.2020, 03.09.2020, 16.09.2020, 12.09.2020, 13.09.2020, 14.09.2020, 15.09.2020, 17.09.2020, 18.09.2020, 20.09.2020, 21.09.2020, 22.09.2020, 23.09.2020, 24.09.2020, 10.10.2020, 12.10.2020, 17.10.2020, 18.10.2020, 24.10.2020, 25.10.2020, 26.10.2020, 28.10.2020; Dokument identifikimin për ankuesin; Autorizimin e datës 10.03.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 3267/2023 e datës 03.04.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 3601/2023 e datës 14.04.2023; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Inspektor Sanitar i datës 01.06.2011; Emailin e datës 10.01.2022 nga F.K për S.K, ankuesin dhe S.R; Emailin e datës 10.01.2022, 06.01.2022 nga S.K për ankuesin dhe S.R; Listën e pagave maj 2020 për ankuesin; Kërkesën për pagesë të orëve shtesë gjatë vikendit e datës 18.02.2022 nga ankuesi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pa palejueshme, **sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe së i njëjti sipas Aktit të Emërimit me numër protokolli 3742 të datës 21.08.2012 ushtron pozitën e punës *Inspektor Sanitar*. Me tej nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesi më datë 06.01.2022 dhe 18.02.2022 kishte parashtruar kërkesë të Kryeshefi i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë dhe Shefi i Sektorit Sanitar për kompensimin e pagës shtesë për punonjësit e institucioneve shtetëror të angazhuar në aktivitetet për mbrojtje dhe parandalimin e COVID-19. Për shkak të mos përgjigjes së organit të punësimit në kërkesat e ankuesit të datës 06.01.2022 dhe 18.02.2022, ankuesi serish me datë 22.03.2023 parashtron kërkesë të njëjtë të menaxhmenti i lart i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, ndërsa me datë 29.03.2023 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të heshtjes administrative të organit të punësimit lidhur me kërkesën e datës 06.01.2022 dhe 22.03.2023 për kompensimin e orëve të punës jashtë orarit të punës, duke pretenduar që e drejta në kompensim bazohet në nenin 7 të Rregullores N.r.12/2020 si dhe nenin 20 paragrafi 1 të Ligjit Nr.07/006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19. Propozon që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të detyroj Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë që ankuesit t' i kompensoj pagën shtesë për punë jashtë orarit dhe vikendeve për periudhën nga data 12.04.2020 deri më datë 18.10.2020 gjithsej 1000 orë pune.



Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmerinë e ankesës i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenit 98 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: 1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure.* 2. *Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, si dhe nenit 127 paragrafi 1 dhe 4 i të njëjtët ligj ku përcaktohet se: "1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ..."* andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe nisur nga kërkesa e fundit e ankuesit e datës 22.03.2023, Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit e datës 29.03.2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e paraafatshme, sepse ankuesi ende pa kaluar afati ligjor për përgjigje në kërkesën e ankuesit gjegjësisht ende pa përfunduar afati për përfundimin e procedurës administrative të iniciuar sipas kërkesës së datës 22.03.2023 dhe rrjedhimisht ende pa u përmbushur kriteri kohor lidhur me heshtjen administrative, parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Kështu që mbi ekzistimin e këtyre fakteve rrjedh se ankesa e ankuesit është papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligj."

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.583/2023

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësueses së ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.